

STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“DST2” SHPK

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Në Tiranë, sot më date 18 Prill 2024 (dymijë e njezet e kater), nëmbështetje të ligjit dhe nëbazë të dispozitave ligjore të Ligjit Nr 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjit Nr 9723 datë 3.5.2007, ndryshuar me Ligjin nr. 9916, datë 12.05.2008, Ligjin Nr.92/2012 dhe Ligjin Nr.8/2015 “Për Qendrën Kombëtare të regjistrimit” që rregullojnë marrëdhëniet tregtare dhe funksionimin e shoqërive, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin: “DST2” SHPK.

Themeluesit e shoqërisë është:

Znj. Joanna Abraham, e lindur me 27/08/1982, ne Poloni, me shtetesi Shqiptare dhe rezident ne Kompleksi Sun Rise, Lunder, mbajtes i kartes ID n. 036453988 dhe numer personal I25827168P, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,

Z.Sindi Sinemati, lindur më 21/12/1990 në Tirane dhe rezident në Rr. Medar Shtylla, Kompleksi Kika, Shk.nr.6, Ap.nr.31, Tirane mbajtës i kartes se identitetit nr. 034185092 me nr. personal J01221056V me aftësi të plotë juridike për të vepruar.

Z. Indrit Demiraj, lindur më 19/11/1990 në Lushnje dhe rezident në Rr. Marko Bocari, Hyrja 1, Apt 7/1, mbajtës i pasaportes nr. BR1178173 dhe nr. Personal J01119044I me aftësi të plotë juridike për të vepruar,

Shoqëria “DST2” Shpk e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozitat e parashikuara në dokumentat e krijimit të saj.

Shoqëria “DST2” Shpk është person juridik. Ajo e fiton këtë të drejtë si person juridik nga data e regjistrimit të kësaj shoqërie në QKB sipas Ligjit.

Neni 2:

Objekti

Shoqëria “DST2” Shpk, do të ushtrojë aktivitetin e saj në fushën e:

Investimi ne menyre direkte ose me pjesemarrje ne cdo forme biznesi te lejuar nga legjislacioni ne Republiken e Shqiperise. Hapja e bareve, restoranteve apo ambjenteve te ndryshme rekreative. Investimi privat ne fushen e ndertimit te veprave te ndryshme publike dhe private, veprave energjitike; ndihma e kompanive financiare dhe menaxhimi financiar i tyre nepermjet menaxhimit te pasurive te luajtshme ose te paluajtshme dhe administrimi i aksioneve. Krijimi dhe strukturimi apo ristrukturimi i firmave te ndryshme. Aktivitet ne fushen e pasurive te patundshme, nepermjet shitjes, blerjes, dhenies me qira te pasurive te ndryshme te paluajtshme, keshillimit juridik e financiar ne kete fushë. Sigurimi i kolateraleve dhe garancive per palet e

treta qe mund te jene persona fizik ose juridike. Organizimin e kurseve te formimit profesional, te trajtimeve te ndryshme ne fushen e tregtimit online nepermjet internetit por edhe ne fushe te pergjithshme. Marrje dhe /ose dhenie te pasurive te paluajtshme dhe /ose te luajtshme me qira. Ndertimi, financimi, rehabilitimi, permiresimi, mirembajtja e objekteve dhe infrastruktures per banim, industriale, tregtare apo turistike, sherbime marketingu si dhe çdo aktivitet tjetër të ligjshëm.

Neni 3: Kohëzgjatja

Shoqëria "DST2" Shpk krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj me një afat të pacaktuar. Kjo shoqëri mund ta mbyllë aktivitetin e saj edhe para mbarimit të këtij afati, e realizuar kjo sipas dispozitave që përcaktohen në këtë statut, me vendim të asamblesë së ortakëve dhe sipas kriterëve që përcaktohen në legjislacionin në fuqi.

Neni 4: Selia

Kjo shoqëri do ta ketë selinë e saj në adresën: Tirane, rruga Andon Zako Çajupi, pallati 20/1, shkalla 1, kati 4, ap.18

Kreu II Kapitali

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i kësaj shoqërie përbehet në para (Lekë) në shumën prej 1,000,000 (nje milion) Lekë me 3 (tre) pjesë.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- 1. Ortaku themelues Joanna Abraham – zoteruese i 1 (një) kuote, në vlere 500,000 (peseqind mije) lek që përbën 50% të kapitalit.**
- 1.Ortaku themelues Sindi Sinemati – zoterues i 1 (një) kuote, në vlere 330,000 (treqind e tridhjete mijë) lek që përbën 33% të kapitalit.**
- 2.Ortaku themelues Indrit Demiraj – zoterues i 1 (një) kuote, në vlere 170,000 (nje qind e shtatedhjete mijë) lek që përbën 17% të kapitalit.**

Kapitali themeltar ose pjesë të caktuara të tij janë të transferueshme nga Ortakët e kësaj shoqërie tek të tretët.

Të gjitha veprimtaritë e shoqërisë mbi kapitalin themeltar në natyrë bëhen vetëm me miratimin e Asamblesë së Ortakëve. Vlerësimi i këtij kapitali bëhet nga ortakët e shoqërisë dhe me vendim të Asamblese se Ortakeve dhe nga një ekspert i autorizuar i caktuar nga vetë Asambleja e Ortakeve. Shoqëria "DST2" Shpk, për detyrimet që do të lindin gjatë aktivitetit të saj me të tretët



përgjigjet vetëm me pasuritë e saj. Ortakëte kësaj shoqërie nuk përgjigjen për detyrimet e kësaj shoqërie me pasuritë e tyre që nuk janë futur në kapitalin e kësaj shoqërie. Pjesmarrja në këtë shoqëri nuk i pengon ortakët të kenë pavarësi ligjore, organizative dhe të drejta pronësie jashtë kësaj shoqërie.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në bazë të një pavarësie të plotë ekonomike. Ajo nuk pranon asnjë ndërhyrje nga organet shtetërore apo publike të çfarëdo lloji, përjashtuar kontrollit që ka të drejtë të bëjnë organet shtetërore kompetente në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e



pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:



- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

1. Kompania administrohet, në mënyrë të alternuar, sipas vendimit të aksionarëve:
 - a) nga një administrator i vetëm;
 - b) nga dy ose më shumë administratore me kompetenca të përbashkëta, të ndara ose të ushtruara bashkarisht.

Me organ administrimi nenkuptohet administratori i vetëm ose grup i administratorëve që i është ngarkuar administrimi sebashku ose veç e veç.

Administratorët mundet që të mos jenë ortakë të shoqërisë.

Administratorët qëndrojnë në detyrë deri në revokimin ose dorëheqje ose për periudhën e përcaktuar nga aksionarët në afatin e emërimit por jo më shumë se 5 vjet dhe mund të riemërohen.

Nëse administratorët janë emëruar për një kohë të caktuar, shkarkimi para afatit detyron kompaninë për kompensim të çdo dëmi, përveç se kur ekziston një kauzë e drejtë.

Me "kauzë të drejtë" nenkuptohet ndodhja e rrethanave ose fakteve, edhe totalisht të panjohura nga administratori ose jashtë vullnetit të tij, të tilla që të minojnë vazhdimin e marrëdhënies së besimit që duhet të ekzistojë midis aksionarëve dhe administratorëve. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
2. Pushimi i administratorëve përshkak të perfundimit të afatit ka afekt nga momenti kur organi i ri i administrimit është emëruar.

Në rastet e parashikuara ne dy paragrafët e mësipërm, administratorët ende në detyrë, në rast të pamundësisë apo të inaktivitetit të tyre, organi mbikëqyrës, nëse është emëruar, duhet, brenda shtatë ditëve, ti paraqesi për vendimmarrje asamblese të aksionarëve emërimin e organit të ri të administrimit; ndërkohë që ata mund të kryejnë vetëm administrimin e zakonshëm.

3. Organi i administrimit ka kompetenca të plota për menaxhimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, pa përjashtim, dhe ka fuqinë për të ndërmarrë ndonjë veprim që e konsideron të përshtatshme për zbatimin dhe arritjen e qëllimit të kompanisë, përveç ato të cilat ligji apo statuti ja rezervon në mënyrë ekskluzive asamblese së ortakeve.

4. Në rastin e emërimit të më shumë se një administratori të cilet nuk përbëjnë një keshill administrimi, kompetencat e zakonshme dhe të jashtëzakonshme administrative mund t'i atribuohet atyre bashkërisht, individualisht ose me shumice, pra kompetenca të caktuara mund t'i atribuohet të ndara dhe të tjera së bashku. Në mungesë të ndonjë përcaktimi në aktin e emërimit në lidhje me format e ushtrimit të kompetencave, ato kompetenca nenkuptohet që i janë dhënë administratorëve bashkarisht.

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të therasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Administrator i përgjithshëm i shoqërisë do të jetë:

Z. Indrit Demiraj, lindur më 19/11/1990 në Lushnje dhe rezident në Rr. Marko Bocari, Hyrja 1, Apt 7/1, mbajtës i pasaportes nr. BR1178173 dhe nr. Personal J01119044I me aftësi të plotë juridike për të vepruar,

Emri, Mbiemri,	Specimeni i firmës
Z. Indrit Demiraj	

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësia e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Per

Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit Padi tësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Kreu V


Prishja – riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpermdarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit Nr 9723 datë 3.5.2007, ndryshuar me Ligjin nr. 9916, datë 12.05.2008, Ligjin Nr.92/2012 dhe Ligjin Nr.8/2015 “Për Qendrën



Kombëtare të Regjistrimit”;

d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “Shoqeri ne likuidim e siper”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.” i ndryshuar.

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarrëveshjet


Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR


“DST2”

ORTAKËT E SHOQËRISË

Z. Sindi Sinemati

SINDY SINEMATI


Znj. Joanna Abraham

Joanna Abraham


Z. Indrit Demiraj

Indrit Demiraj
